



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN
Nr. i aktit / Nr. / 127/23
Nr. i aktit / Nr. / st _____
Datë / Datum 08.02.2023



VUSHTRRI - VUČITRN
REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në pajtim me Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2022-2026 për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës dhe Planin e Veprimit 2022-2024, Kryetari i Komunës me datën 08.02.2023 merr këtë:

V E N D I M PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES

1. Themelohet Komiteti Veprues në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 z. **Shpëtim Zhegrova**, Nënkyetar i Komunës - kryesues,
 - 1.2 z. **Dardan Abazi**, Drejtor për Arsim - anëtar,
 - 1.3 z. **Nexhmedin Rashica**, Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale - anëtar,
 - 1.4 znj. **Fortuna Krasniqi**, Drejtore për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - anëtar,
 - 1.5 znj. **Hyrije Uka**, Zyrtare për të Drejtat e Njeriut - anëtare,
 - 1.6 znj. **Remzije Zekolli**, Zyrtare për Barazi Gjinore - anëtare,
 - 1.7 z. **Abit Abiti**, Zyrtar Kryesor Financiar - anëtar,
 - 1.8 z. **Ekrem Merovci**, Zyrtar për Komunitete dhe Kthim – Koordinator i KKV,
 - 1.9 z. **Xhavit Musa**, OJQ “Së Bashku për Zhvillim Demokratik”
2. Qëllimi i themelimit të Komitetit Komunal Veprues është implementimi i aktiviteteve komunale të përcaktuara në Strategjinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2022-2026 për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës dhe Planin e Veprimit 2022-2024. Komiteti gjithashtu do të shërbej si një strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë në kuadër të procesit të zbatimit dhe monitorimit të strategjisë.
3. Komiteti Komunal Veprues duhet t'i mbaj të paktën 6 takime në vit ose një takim në çdo dy muaj.
4. Takimet e Komitetit ftohen nga kryesuesi i komitetit përmes koordinatorit të KKV-së.
5. Mandati i komitetit është i njëjtë me kohëzgjatjen e Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës të cekur në këtë vendim.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komitetit Veprues
- Ministrisë së Pushtetit Lokal
- Arkivit të Sekretarisë



Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Ferit Idrizi